

Intervistë e Ministrit Sadri Ferati dhënë të përditshmës Kosova sot

“Kosova Sot”: Cili është vlerësimi juaj për ecurinë e deritashme të procesit të decentralizimit, një proces shumë i përfolur dhe mjaft sfidues?

Ferati: Jo vetëm që është vlerësim yni, por edhe në të gjitha vlerësimet e tjera, edhe në raportin e progresit dhe në të gjitha deklaratimet pas zgjedhjeve lokale, i gjithë vlerësimi rreth decentralizimit është se kjo fazë është implementuar me sukses, me gjithë sfidat. Unë dua të konstatoj përsëri se kjo fazë e decentralizimit ka përfunduar me sukses, me themelimin e tri komunave të reja dhe zgjerimin e Komunës së Novobërdës.

“Kosova Sot”: Por, procesi nuk ka përfunduar me këtë, në agjendë është pjesa tjetër...

Ferati: Po, tani po bëhen përgatitjet që të vazhdohet më tutje me Mitrovicën edhe Parteshin. Tanimë në Partesh veç është caktuar edhe data e zgjedhjeve. Unë e kam vizituar këto ditë edhe ekipin përgatitor në Partesh dhe nga ata i mora të gjitha sinjalet se Parteshi është i gatshëm për të shkuar në zgjedhje.

Presioni ndaj Grupit

“Kosova Sot”: Përgatitjet janë edhe për Mitrovicën, sikur e thatë. Si po shkojnë ato?

Ferati: Thashë që me Parteshin jemi gati, ndërsa për Mitrovicën do të na duhet edhe një progres më shumë, një përparim i nevojshëm, në mënyrë që me rastin e implementimit të projektit atje të krijohet një komunë, e cila do të ofrojë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallime, edhe etnike dhe pa asnjë dallim tjetër. Pra, po përgatitemi që ta themelojmë vërtet një komunë që do t'i shërbejë interesit gjithëpërfshirës të qytetarit dhe nuk do të jetë aty vetëm sa për të qenë në formë.

“Kosova Sot”: Ka pasur disa informacione për një presion që bëhet ndaj anëtarëve të grupit punues në veri të Mitrovicës. Sa në të vërtetë janë të shprehura presionet e tilla?

Ferati: Shikoni, ne në këtë situatë edhe nuk na befasojnë presionet. Ne edhe kemi llogaritur paraprakisht se mund të ketë presione. Gjatë intervistimit edhe të kandidatëve që të gjithëve iu është shtruar si pyetje se nëse do të ketë presion apo rezistencë, jo mirëkuptim nga mesi ose qarqet e ndryshme, a do të jenë të gatshëm t'i përballojnë ato. Të gjithë kanë deklaruar se janë të gatshëm. Tash ka sinjale se ka pasur kërcënime individuale, por jo në sistem dhe masë të madhe, por si reagime individuale. Ne kemi disa sinjale se disa anëtarë janë frikësuar paksa, por akoma asnjëri prej tyre nuk ka tërhequr kontratën që e kemi arritur për bashkëpunim me ministrinë. Pra, të 14 anëtarët e ekipeve përgatitore, prej tyre 9 të komunitetit serb, tre shqiptarë dhe dy boshnjakë myslimanë, akoma janë nën kontratë në ekipet përgatitore.

Pa afat për Mitrovicën Veriore

“Kosova Sot”: A mund të na thoni konkretisht se kur pritet të formohet komuna e veriut në Mitrovicë?

Ferati: Jo, ne tani nuk po flasim për data, ngase progresi i nevojshëm që duhet të jetë atje është prioriteti kryesor. Pasi ne nuk jemi në një situatë që tash ta dimë se pikërisht cila është koha e përafërt kur do të mund të identifikohet si real ai progres, pra edhe nuk mund të flitet për data. Do të kishim dëshiruar që kjo të ndodhte në vjeshtë, sepse teknikisht ne mund të përgatitemi mjaft deri atëherë, por cili do të jetë progresi në terren akoma nuk e dimë, prandaj nuk preferojmë

që tash të japim data.

“Kosova Sot”. A keni mbështetje, të themi të formës logjistike, nga komunat e reja për të sqaruar interesin e tillë edhe në pjesën veriore të vendit ku pret procesi i filluar?

Ferati: Po, gjithsesi. Edhe ky është një proces normal që ne edhe presim se vetëm duke krijuar shembuj pozitivë për lokalitetet që i përmendëm, ajo do të na shërbejë në dy drejtime. Ne do t'i përdorim këta shembuj dhe do t'i informojmë në vazhdimësi qytetarët. Për këtë do të bëjmë edhe fushata nëpërmes mjeteve të informimit që të gjitha produktet pozitive dhe progresi që po ndodh në këtë pjesë të Kosovës me komunat e reja të pasqyrohen dhe për qytetarët e pjesës veriore të Kosovës.

Ka progres

“Kosova Sot”: Po niveli i bashkëpunimit konkret me komunat e reja, sa i përgjigjen ato realisht Qeverisë së Kosovës?

Ferati: Bashkëpunimi është i një niveli shumë të mirë. Ne e kemi dhënë mbështetjen paraprake dhe tash është ajo faza e instalimit të administratës si strukturë komunale me një progres shumë të mirë. Progres po shënohet në të tria komunat, Graçanicë, Kllokot dhe Ranillug. Unë e kam pasur rastin t'i vizitoj Graçanicën dhe Ranillugin dhe jam i kënaqur me këtë fillim. Ne kemi ndarë edhe fondet përkatëse, i kemi informuar komunat se cili është buxheti në të cilin mund të llogaritet si mbështetje nga ana e ministrisë dhe ata janë në përpilim e sipër të projekteve konkrete që do të financohen atje. Në përgjithësi, për muajt e fillimit jemi shumë të kënaqur me këtë bashkëpunim dhe ecje përpara. Po them se ka raste kur kemi komunë me traditë që akoma nuk i ka konstituuar bordet dhe nuk i kanë emëruar drejtorët, kurse në komunat e reja këto punë janë kryer të gjitha dhe vërehet një intensitet i shtuar i punës. Pra, unë jam i kënaqur, sepse po shihet në fillim që ato komuna do të mund të zhvillohen mirë.

“Kosova Sot”: Kur i shihni si të afta që edhe në aspektin buxhetor të fillojnë të pavarësohen dhe të mbijetojnë si duhet?

Ferati: Në aspektin e menaxhimit të burimeve financiare që iu shkojnë atyre, ata veç tash janë duke bërë diçka të tillë, me përjashtim të zyrave të prokurimit, që kërkojnë persona të certifikuar që ata nuk i kanë. Ose e kanë marrë ndonjë person profesional nga ndonjë institucion tjetër, ose procedurat i zhvillojnë te ne në ministri. Kur është fjala për të hyrat vetjake, ata do të duhet të presin edhe për pak kohë, sepse tash janë në zhvillim të proceseve, të vendimeve për tatimet në pronë, përcaktimin e rregulloreve për taksat komunale etj. Këto janë ato segmente që krijojnë të hyra komunale dhe do të qartësohen në vijim, një përgatitje që do të marrë kohë.

“Kosova Sot”: Sa jep sinjale dinamika e deritashme e këtij procesi, që decentralizimi mund të përfundojë brenda këtij viti apo do të bartet në vitin që vjen?

Ferati: Unë dua të përkujtoj që me pakon e Ahtisarit implementimi është trevjeçar dhe me rendin e punës është deri më 2011. Gjatë këtij viti, pra brenda këtij muaji, ne do të raportojmë se cilat janë rezultatet e punës dhe çka ka mbetur ende pa u realizuar. Bëhet fjalë për Komunën e Mitrovicës dhe Parteshin. Ne po shohim se ka progres dhe rritje të interesimit të qytetarëve që të jenë në bashkëpunim me ne, por ka edhe sfida, sepse pikërisht Mitrovica është ajo pjesë e Kosovës në të cilën ne nuk e kemi bërë një mjedis të sigurt, që njerëzit ta shprehin lirshëm mendimin dhe organizimin e tyre politik dhe interesin për të cilin ata përcaktohen. Ky është një rast për ata, ne do ta zhvillojmë që kjo t'u shërbejë. Mirëpo, nëse atje nuk krijohen kushte për shkak të politikave ekstreme, për shkak të krimit të organizuar dhe çështjeve të tjera që do të marrin më

shumë kohë, ne do të shprehim keqardhjen tonë pse është ashtu por ne do të punojmë që kjo të realizohet sa më shpejt, sepse kjo do t'i shërbejë interesit të qytetarëve dhe do ta promovojë funksionalizimin e shoqërisë kosovare dhe institucioneve të shtetit të Kosovës.

“Kosova Sot”: Në muajin mars, Beogradi po bën përgatitje për zgjedhje lokale edhe në disa komuna të Kosovës. Sa do ta sfidojë dhe do ta vështirësojë ky plan procesin e filluar për komunën e veriut të Mitrovicës?

Ferati: Natyrisht, është diçka që ne nuk e dëshirojmë dhe kemi të bëjmë me pengesë të natyrës së njëjtë, që edhe deri tash për 9 vjet e kanë stagnuar jetën, sidomos në atë pjesë të Kosovës. Procesi ynë është i pavarur dhe nuk kushtëzohet nga asnjë proces tjetër që provon ta bëjë Beogradi. Nga të gjitha sondazhet që ne i kemi, të gjithë qytetarët e asaj pjese janë deklaruar se nuk janë të kënaqur me atë kualitet të jetës dhe se dëshirojnë ta ndryshojnë mënyrën e jetës. Pikërisht projekti ynë është ai i cili iu mundëson ndryshimin e mënyrës së jetës dhe kualitetin. Jam i bindur se në staza afatmesme Beogradi, me këtë qëllim, nuk do të mund të na pengojë, por nuk e përjashtoj mundësinë që na ka humbur vetëm ndonjë muaj.

Intervistoi: S. AHMETI